



Pranuar / Dorëzuar Prilijeno/Prodato Received/Delivery	21.05	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot.No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMSTICK	4405/2023		114



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.561/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.561/2023 të datës 27.03.2023 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit Agjencia për Informim dhe Privatësi, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, Nenin 16 paragrafi 3 dhe Nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 23.05.2023, mori këtë:

### V E N D I M

*Hedhet poshtë si e palejuar* ankesa me numër A.nr.561/2022 e datës 27.03.2023, e parashtruar nga ankuesi

### A r s y e t i m

Ankuesi (tutje vetëm ankuesi) më datë 27.03.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit nën shenjë Akti.nr.72/2023 të datës 21.03.2023 të Menaxheres se Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Informim dhe Privatësi, për shkak të refuzimit të aplikacionit për të vazhduar tutje në procedurën e rekrutimit sipas konkursit të datës 08.02.2023 për grupin Specialist Ligjor/zyrtar për inspektim, me pretendim ankimore se vendimi për refuzimin e aplikacionit është i pa bazuar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme Këshilli) në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 03.04.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Agjencinë për Informim dhe Privatësi, ndërsa kjo e fundit më datë 14.04.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat referuar kësaj çështje juridiko-administrative.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të

Kosovës, me Vendimin me numër protokollit 4146/2023 të datës 10.05.2023 ka vazhduar afatin për vendimmarrje lidhur me ankesën e ankuesit edhe për dhjetë (10) ditë pune.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:* Ankesën me numër të protokollit 3005/2023 të datës 27.03.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin nën shenjen Akti.nr.72/2023 të datës 21.03.2023 të Menaxheres së Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Informim dhe Privatësi; konkursin me numër të referencës RN00010952 të datës 08.02.2023; Emalin e datës 27.03.2023 të drejtuar KPMSHCKS-së; Certifikatën nën shenjen PN.Nr. 24428/2022 e datës 26.09.2022 nga evidenca e personave kundër të cilëve është duke u zhvilluar procedura penale dhe personave të dënuar nga kjo Gjykatë të lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë; Njoftimin nga SMBNJ të datës 22.03.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 03.04.2023; Përgjigjen në ankesë të datës 14.04.2023; Konkursin me numër të Referencës; RN00010952 të datës 08.02.2023 për grupin Specialiste Ligjore , titulli i vendit të punës "Zyrtar për Inspektim"; Ankesën e datës 22.03.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbime Civil të Kosovës; Vendimin nën shenjen Akti.nr.201/2023 të datës 29.03.2023 të Menaxheres së Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Informim dhe Privatësi; Dosjen e ankuesit; aplikacionin e datës 02.03.2023; Diplomën universitare me Nr.2327/20 të datës 26.11.2020; Shkresën me numër të protokollit 1219 të datës 01.06.2021 të lëshuar nga Drejtori i Shërbimeve për Burime Njerëzore dhe Organizim në NLB Banka; Vërtetimin e datës 01.06.2021 të lëshuar nga Zyra e Burimeve Njerëzore në kompaninë e sigurimeve Illyria; Letër rekomandimin/Vërtetimin e datës 12.02.2022 të lëshuar nga kompania private BIIS; Certifikatën e datës 03.03.2021; Certifikatën e datës 18.02.2020; Dokumentin e identifikimit; Letër rekomandimin e datës 28.05.2009 të lëshura nga Kryetari i Bordit udhëheqës në NLB Bankën; Vendimin VK/2023 të datës 10.05.2023 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës; Emalin e datës 12.05.2023 të drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Emalin e datës 16.05.2023 të drejtuar KPMSHCK-së; Emalin e datës 16.05.2023 të KPMSHCK-së drejtuar Emalin e datës 11.05.2023 të KPMSHCK-së drejtuar Emalin e datës 17.05.2023 të drejtuar KPMSHCK-së; Emalin e datës 16.05.2023 KPMSHCK-së; Emalin e datës 16.05.2023 të KPMSHCK-së drejtuar Emalin e datës 12.05.2023 të drejtuar KPMSHCK-së; Emalin e datës 11.05.2023 të KPMSHCK-së drejtuar Konkursin e datës 26.07.2023 me numër reference RN00009610 për pozitën e punës "Zyrtar inspektimi"; Konkursin e datës 22.07.2023 me numër referencës RN00009582 për grupin Specialit Ligjore;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së është e palejuar ankesa e ankuesit, *sepse:*

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë se Agjencia për Informim dhe Privatësi, më datë 08.02.2023 ka publikuar Konkursin me numër reference RN00010952 për grupin e pozitive *Specialistë Ligjor/Zyrtar i Inspektimit* në Divizionin e Inspektimit dhe Kontrollit, klasa profesional 2, një pozitë. Konkursi ka qenë hapur aplikimin nga data 01.03.2023 deri 08.03.2023, e në të cilin konkurs ka aplikuar dhe ankuesi.

Me tej nga shkresat e lëndës rezulton së Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Informim dhe Privatësi, në fazën e verifikimit paraprak përmes vendimit nën shenjen



Akti.nr.72/2023 të datës 21.03.2023, ka refuzuar aplikacionin e ankuesit, me arsyetim se ankuesi nuk ka bashkangjitur dëshmi nga gjykata lidhur me mos dënim me vendim të formës, e kërkuar sipas konkursit në pikën 2 nën-pika 5.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin për refuzimin e aplikacionit, më datë 22.03.2023 ka parashtruar ankesë pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore, ndërsa me datë 27.03.2023 përmes emalit ankuesi ka parashtruar ankesë me numër protokolli 3005/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës kundër Vendimit nën shenjen Akti.nr.72/2023 të datës 21.03.2023 të Menaxheres së Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Informim dhe Privatësi, me pretendim ankimore se vendimi i kundërshtuar është i pa bazuar, sepse në konkursin e shpallur me numër reference RN00010952 nuk është specifikuar se kërkohen dokumente për të dëshmuar se nuk jam i dënuar me vendimin e formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje. Ndërsa, Njësia e Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Informim dhe Privatësi me datën 29.03.2023 ka nxjerr vendimin nën shenjen Akti.nr.201/2023 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar.

Në kuptim të pranueshmerinë së ankesës, Kolegji i Këshillit ju referua dispozitave të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenit 15 paragrafi 6 më të cilin është përcaktuar se: *"..6.Brenda tre (3) ditëve nga data e njoftimit individual, në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni, kandidatët e njoftuar që nuk plotësojnë kushtet e aplikimit, kanë të drejtë të paraqesin ankesë të brendshme. Ankesa parashtrohet më shkrim pranë Njesisë Përgjegjëse. Ankesa shqyrtohet nga Njësia Përgjegjëse e cila me vendim e njofton kandidatin brenda pesë (5) ditëve nga paraqitja e saj.."* si dhe nenin 31 paragrafi 1 dhe 2 të kësaj rregullore më të cilin parashihet se: *1.Kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil, i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtrorë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (në vijim në tekstin e kësaj Rregullore "Këshilli") . 2. Ankesa në Këshill parashtrohet vetëm pas shqyrtimit të procedurës të brendshme të ankesës të organit përkatës që ka nxjerrë aktin apo kryer veprimin që kundërshtohet..* dhe si rrjedhojë mbi bazën e këtij përcaktimi ligjor dhe bazuar në shkresat e lëndës Kolegji i Këshillit konstaton së ankuesi ende pa përfunduar afati për vendosje nga njësia e Burimeve Njerëzore, parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil. Përkatësisht ankuesi kishte parashtruar ankesë të njësia përgjegjëse me datë 22.03.2023 e cila bazuar në dispozitat ligjore si me lart ka në posedim afatin ligjor prej pesë (5) ditëve për vendosje, ndërsa ankuesi me datë 27.03.2023 gjegjësisht në ditën e fundit për vendosje nga Njësia e Burimeve Njerëzore parashtron ankesë në Këshill, kështu që mbi bazën e këtyre rrethanave ankesa e ankuesit A.nr.561/2023 e datës 27.03.2023 e ushtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e palejueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.


Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit pas analizimit të shkresave të lëndës si dhe në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** *Ky vend hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda A.nr.561/2023

Ilire Mehmeti-SHAQIRI

  
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë për Informim dhe Privatësi; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.